



## VENDIM

*Nr. 99 Datë 07.11.2014*

### **PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KESH SH.A. PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.77, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës **07.11.2014**, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për vitin 2015 dhe relacionin e grupit të punës,

#### **Konstatohet se:**

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike nga KESH sh.a.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### **Vendos:**

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2015
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

**VENDIM**

*Nr. 99 Datë 07.11.2014*

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KESH SH.A. PËR VITIN 2015**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundra
<b>Petrit Ahmeti</b>	_____	_____
<b>Adriatik Bego</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Maksim Shuli</b>	_____	_____